



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-14

PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Rregullores nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, veçanërisht Kreut 5.1(ç), 9.1.1, 9.3.3, 11.2.

Me qëllim të mbrojtjes dhe aplikimit të standardeve në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi dhe fusha e zbatimit
Neni 1

1.1. Ky ligj përcakton kushtet për përdorimin dhe hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit, pranimin e miratimeve teknike për këto produkte, vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit në lidhje me kërkesat themelore, kryerjen e mbikëqyrjes së tregut dhe zbatimin e procedurave të veçanta për njohjen e konformitetit të tyre.

1.2. Ky ligj rregullon nxjerrjen në treg të produkteve të ndërtimit, karakteristikat e të cilëve janë në përputhje me kërkesat themelore për objektet e ndërtimit sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 2

2.1. Ky ligj do të zbatohet për ato produkte ndërtimi, në masën që i plotëson kërkesat themelore për objektet e ndërtimit të parapara me nenin 3. të këtij ligji. Ky ligji nuk zbatohet për produktet, për të cilat specifikimet teknike që i referohen neneve 5 ose 6 nuk ekzistojnë dhe karakteristikat teknike të tyre janë rregulluar me ligje të veçanta ose rregulla teknike në zbatim të këtyre ligjeve.

2.2. Pas përcaktimit të specifikimeve teknike sipas neneve 5 dhe 6 të këtij ligji ,për hedhjen në treg të produkteve të ndërtimit do të zbatohen vetëm kërkesat e këtij ligji. Kërkesat që u takojnë produkteve të ndërtimit që dalin në treg dhe janë përcaktuar me rregulla të veçanta, nuk do të aplikohen kur periudha e përcaktuar me këto specifikime teknike përfundon.

2.3. Ky ligj nuk rregullon përdorimin e produkteve të ndërtimit gjatë ndërtimit të objektit të ndërtimit. Dispozitat dhe aktet tjera për ndërtimin e objekteve të ndërtimit nuk guxojnë të përjashtojnë përdorimin e produkteve të ndërtimit të cilat janë hedhur në treg në pajtueshmëri me dispozita e këtij ligji, për destinimin e parashikuar.

Neni 3

3.1. Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit të cilat përcaktohen në rregulloret për punimet e ndërtimit, duhet të plotësohen duke pasur parasysh karakteristikat kryesore të produkteve:

- i. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;
- ii. sigurinë në rast zjarri;
- iii. higjienën, shëndetin dhe mjedisin;
- iv. sigurinë në përdorim;
- v. mbrojtjen kundër zhurmave;
- vi. kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.

3.2. Ministria kompetente nëpërmjet rregulloreve për produktet e ndërtimit, përcakton karakteristikat e produkteve të ndërtimit në pajtim me kërkesat themelore.

3.3. Për të vendosur lidhjen e nevojshme ndërmjet kërkesave themelore nga paragrafët 1 dhe 2 dhe specifikave teknike të parapara me nenin 6, Ministria nxjerr botime speciale të përkthimeve në gjuhën shqipe të dokumenteve interpretuese të publikuara nga Komisioni Evropian.

KAPITULLI II DOMETHËNIA DHE INTERPRETIMI I TERMAVE

Neni 4

Termat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1. **Ministria kompetente** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
2. **Ministër** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë,
3. **Komisioni** - Komisioni i Komunitetit Evropian,
4. **EOTA** - Organizata Evropiane për Miratime Teknike,
5. **Produkt ndërtimi** - çdo produkt i prodhuar për tu përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit,
6. **Punime ndërtimi** - ndërtimi i objekteve dhe punimet në fushën e inxhinierisë civile,
7. **Nxjerrja në treg** - bërja e një produkti ndërtimi të përshtatshëm për përdorim në Kosovë,

8. **Furnizues** - prodhuesi i produkteve të ndërtimit në qoftë se prodhuesi nuk ka një zyrë të regjistruar, përfaqësuesi i tij që ka zyrë të regjistruar në Kosovë; një importues ose çdo person juridik ose fizik që ka nxjerrë produktin në treg,
9. **Specifikat teknike** - standarde, miratime teknike dhe rregulla teknike të Kosovës sipas neneve 5 dhe 6,
10. **Specifikime teknike të pranuar** - standarde të Kosovës ose miratime teknike të Kosovës të cilat Komisioni i Komunitetit Evropian (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i pranon të tilla, përkatësisht pranon se produktet e prodhuara në përputhje me to bëjnë të mundur plotësimin e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit dhe me rekomandimet e publikuara në “Fletoren zyrtare” të Komunitetit Evropian,
11. **Standardi i Kosovës** - standardi i miratuar nga organi për standardizim i Kosovës, në përputhje me rregullat e standardizimit,
12. **Standard i harmonizuar** - standardi i përcaktuar nga Organizata Evropiane për Standardizime sipas propozimit të Komisionit dhe rekomandimeve të botura në “Gazetën zyrtare” të Komunitetit Evropian,
13. **Miratim teknik Evropian** - vlerësimi teknik i përshtatshmërisë për përdorim i një produkti për një qëllim të synuar, bazuar në përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit për të cilat përdoret produkti. Ky miratim jepet nga një organ miratues, që është i notifikuar nga Komisioni për miratime teknike Evropiane,
14. **Miratim teknik i pranuar** - miratimi teknik i një produkti ndërtimi nga një organ miratues në përputhje me legjislacionin e një shteti tjetër,
15. **Miratim teknik i Kosovës** - miratimi teknik i një produkti ndërtimi nga një organ miratues, i regjistruar në Kosovë në përputhje me nenet 17, 18 dhe 19,
16. **Organ miratues** - organi që lëshon miratimet teknike Evropiane ose të Kosovës,
17. **Produkt i vogël ndërtimi** - produkti i ndërtimit i cili nuk ka ndonjë ndikim me rëndësi në shëndetin dhe sigurinë dhe si i tillë përfshihet në listën e ministrit dhe që është botuar në “Fletoren zyrtare” të Kosovës,
18. **Rregull teknologjike e pranuar** - dispozita teknike e cila sipas pjesës më të madhe të ekspertëve paraqet gjendjen e teknologjisë,
19. **Organ certifikimi** - organi i paanshëm që vërteton konformitetin e produkteve të ndërtimit ose të një sistemi për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit,
20. **Organ inspektimi** - organi i paanshëm që vlerëson dhe rekomandon pranimin dhe revizionin e metodave të kontrollit të cilësisë nga prodhuesi, përzgjedhjen dhe vlerësimin e produkteve të ndërtimit në fabrika, reparte prodhimi ose kudo ku ato janë vendosur,
21. **Laborator testimi** - organi që matë, ekzaminon, teston, kalibron ose që përcakton ndryshe karakteristikat ose cilësitë e materialeve ose produkteve të ndërtimit,
22. **Vlerësimi i konformitetit** - procedura nëpërmjet së cilës jepet garanci me shkrim se një produkt, proces ose shërbim është në përputhje me kërkesat e specifikuara,

23. **Vërtetimi i konformitetit** - pranimi paraprak i përputhshmërisë së produktit me specifikat teknike,

24. **Dokument interpretues** - interpretimi i karakteristikave të domosdoshme të produkteve të përshtatshëm për përdorim në përputhje me kërkesat themelore.

KAPITULLI III NXJERRJA NË TREG E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT

Neni 5

5.1. Produktet e ndërtimit mund të dalin në treg vetëm në qoftë se ato janë të përshtatshme për përdorimin e paraparë, ose që kenë karakteristika të tilla që punimet e ndërtimit në të cilat ato do të përfshihen, nëse janë të projektuara dhe ndërtuara në mënyrën e duhur, të përmbushin kërkesat themelore të përcaktuara me rregullat e ndërtimit dhe të punimeve të ndërtimit.

5.2. Një produkt është i përshtatshëm për përdorimin e paraparë dhe mund të nxirret në treg në qoftë se është në përputhje me:

- i. standardet e Kosovës, që janë harmonizuar me standardet përkatëse Evropiane,
- ii. miratimet teknike Evropiane, ose
- iii. specifikimet teknike të pranura kur specifikimet teknike nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nuk ekzistojnë.

Neni 6

6.1. Kur specifikimet teknike nga paragrafi dy të nenit 5 nuk ekzistojnë, një produkt ndërtimi mund të nxirret në treg në qoftë se është në harmoni me:

- i. standardet e Kosovës,
- ii. rregullat teknike të Kosovës, ose
- iii. miratimet teknike të Kosovës në përputhje me nenet 17, 18, 19 të këtij ligji.

6.2. Rregullat teknike nga paragrafi 1. i këtij neni duhet të botohen nga Ministria. Ministria përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ndërtimi dhe procedurat për vlerësimin dhe vërtetimin e konformitetit me rregullat teknike dhe, nëse është e nevojshme, me standardet e Kosovës.

Neni 7

Kur një produkt ndërtimi nuk i plotëson ose i plotëson vetëm disa nga kërkesat e specifikave teknike nga neni 5 dhe 6, atëherë prodhuesi mund ta nxjerrë në treg produktin, vetëm nëse pas zbatimit të procedurave për vlerësimin e konformitetit sipas pikës 1. të nenit 23, ia bashkangjet deklaratën për konformitetin e atij produkti. Në atë rast, deklarimi i konformitetit do të bazohet në testim fillestar të një produkti të kryer në laborator testimi , i cili është miratuar si organ për vërtetimin e konformitetit.

Neni 8

8.1. Një produkt ndërtimi i vogël mund të nxirret në treg në mbështetje të përputhjes së deklaratës së prodhuesit me rregullën teknologjike të pranuar.

8.2. Deklarimi nga paragrafi i mësipërm, bëhet nga prodhuesi nën përgjegjësinë e tij, në rast se plotësohen kriteret e përcaktuara nga standardet e Kosovës për deklaratën e konformitetit.

Neni 9

Ministria përcakton përgjegjësinë dhe mënyrën e shënimit të markës së konformitetit, kërkon vlerësimin e konformitetit të një produkti ndërtimi për vënien e markës së konformitetit. Me markën e konformitetit prodhuesi ose përfaqësuesi i tij konfirmon, para se produkti të nxirret në treg, se është prodhuar në përputhje me standardet.

KAPITULLI IV MIRATIMI TEKNIK

Neni 10

Miratimi teknik është një vlerësim teknik i përshtatshmërisë për përdorim të një produkti për një qëllim të paraparë, duke u bazuar në përmbushjen e kërkesave themelore për punimet e ndërtimit për të cilat ai përdoret.

Neni 11

Një organ miratues mund t'i japë një miratim teknik Evropian një produkti ndërtimi:

- i. për të cilin nuk ka standarde të harmonizuara, as një porosi për një standard të harmonizuar dhe për të cilin komisioni vlerëson se një standard i tillë i harmonizuar nuk mund të hartohet ose nuk mund të hartohet ende,
- ii. i cili ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga standardet e harmonizuara.

Neni 12

12.1 Miratimi teknik Evropian për një produkt ndërtimi mbështetet në ekzaminimet, provat dhe vlerësimet në bazë të dokumenteve interpretues nga paragrafi tre i nenit 3. dhe udhëzimeve të përshtatura për miratimet teknike Evropiane.

12.2. Një udhëzues për një miratim teknik Evropian që i takon një produkti të veçantë ose grupi produktesh, i cili është hartuar nga Organizata Evropiane për Miratimet (EOTA), publikohet nga Ministria si një botim i veçantë.

12.3. Udhëzuesi duhet të përmbajë kryesisht :

- i. listën e dokumenteve interpretuese,
- ii. kërkesat specifike për një produkt ndërtimi në kuadër të kërkesave, themelore për punimet e ndërtimit nga neni 3,

- iii. procedurat e provave,
- iv. metodat e vlerësimit dhe gjykitimit të rezultateve të provave,
- v. vlerësimin e konformitetit dhe vërtetimin e procedurave të cilat duhet t' i përmbushin kërkesat nga neni 21, 22, dhe 23,
- vi. periudhën e vlefshmërisë së miratimit teknik Evropian.

12.4. Kur udhëzuesi nga pika 3 nuk ekziston, miratimi teknik Evropian mund të jepet duke u bazuar në kërkesat themelore përkatëse dhe dokumentet interpretuese. Në këtë rast vlerësimi i produktit është bërë nga organi që vepron bashkërisht me Organizatën Evropiane për miratimet teknike.

Neni 13

Një produkt ndërtimi për të cilin është dhënë një miratim teknik Evropian nga organi miratues nga pika 16. e nenit 4 , mund të nxirret në treg në qoftë se furnizuesi paraqet tek organi i inspektimit të gjitha të dhënat e nevojshme për miratimin teknik të parapara me nenin 27. Në qoftë se një miratim teknik Evropian është i botuar në gjuhë të huaj, furnizuesi duhet ta ketë një kopje të përkthimit shqip.

Neni 14

14.1. Kur një organ miratues ka një zyrë regjistrimi në Kosovë, ai mund të nxjerrë një miratim teknik Evropian vetëm në qoftë se ka autorizim nga Ministria. Ky organ duhet t'i plotësojë kushtet të cilat janë përcaktuar në paragrafët e mëposhtëm dhe Ministria të ketë notifikuar atë në Komision si një anëtar të Organizatës Evropiane për Miratimet Teknike.

14.2. Për të marrë autorizimin sipas paragrafit të mësipërm, një organ miratues duhet veçanërisht të jetë në gjendje:

- i. të vlerësojë përshtatshmërinë për përdorim të produkteve të reja të ndërtimit në bazë të njohurive shkencore dhe praktike;
- ii. të marrë vendime të paanshme në lidhje me interesat e prodhuesve të interesuar ose të përfaqësuesve të tyre, dhe
- iii. të krahasojë kontributet e të gjitha palëve të interesuara në një vlerësim të balancuar.

14.3. Ministria mund të vërë kushte plotësuese për dhënien e autorizimit sipas paragrafit të parë. Autorizimi ka një kohëzgjatje të caktuar. Organi miratues mund të plotësojë në vazhdimësi kushtet për marrjen e autorizimit. Në qoftë se organi miratues pushon së plotësuari kushtet brenda periudhës së vlefshmërisë së autorizimit, autorizimi tërhiqet.

Neni 15

15.1. Kërkesa për miratim teknik Evropian për një produkt ndërtimi mund të bëhet nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij. Me rastin e paraqitjes së kërkesës paraqitësi deklaron se nuk e ka bërë të njëjtën kërkesë në organe të tjera miratuese dhe se i ka paguar të gjitha shpenzimet e procedurës.

15.2. Prodhuesi, para se të bëjë kërkesën sipas paragrafit të mësipërm, pasi t'i ketë paraqitur dëshmitë e nevojshme, mund të kërkojë nga organi përgjegjës për dhënien e miratimit Evropian të informohet për :

- i. procedurën e dhënies së miratimit teknik Evropian,
- ii. afatin e kryerjes së procedurës;
- iii. shpenzimet dhe mënyrën e pagesës së tyre.

15.3. Kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni duhet bashkëngjitur, në zarfë të mbyllur, përshkrimin e produktit të ndërtimit, specifikimet, projektet dhe raportet e provave të cilat detalisht përcaktojnë produktin dhe përdorimin e tij të paraparë. Përveç kësaj paraqitësi i kërkesës duhet të bëjë të njohur të gjitha vendet ku produkti do të ekspozohet dhe t'i krijojë mundësi organit miratues t' i vizitojë ato vende.

15.4. Organi miratues informon paraqitësin e kërkesës se cilat dokumente shtesë, rezultate të provave, llogaritje ose të dhëna të tjera duhet t'i paraqes më pas në mënyrë që të bëhet i mundur vlerësimi i produktit për përdorimin e paraparë. Organi miratues garanton ruajtjen e sekretit për të gjitha informacionet e marra gjatë procedurës.

Neni 16

16.1. Organi miratues jep miratimin teknik Evropian për një produkt ndërtimi për të cilin ai e ka vërtetuar se është i përshtatshëm për përdorimin e paraparë. Është rregull e përgjithshme që miratimi teknik Evropian të jepet për një periudhë pesë vjeçare, vlefshmëria e të cilit mund të zgjatet.

16.2 Për rishikimin e një miratimi teknik Evropian, aplikohen të njëjtat rregulla si për dhënien e tij. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet tek i njëjti organ miratues i cili e ka dhënë miratimin e parë teknik.

16.3. Miratimi teknik Evropian i dhënë mund të anulohet në qoftë se organi miratues konstaton se produkti i ndërtimit nuk është i përshtatshëm për përdorimin e paraparë. Për anulimin e miratimit teknik, organi miratues e informon organin e inspektimit nga neni 27.

16.4. Ministria shpall në detale procedurën për dhënien, vazhdimin, rishikimin dhe anulimin e miratimit teknik Evropian.

Neni 17

17.1. Miratimi teknik i Kosovës për një produkt ndërtimi, duhet të mbështetet në ekzaminimet, provat dhe vlerësimet se a i përmbushë kërkesat themelore për punimet e ndërtimit dhe të dokumenteve interpretuese nga neni 3.

17.2. Miratim teknik i Kosovës sipas këtij neni, mund t'i jepet një produkti ndërtimi të veçantë vetëm nga një organ miratues që ka zyre regjistrimi në Kosovë, që ka autorizim përkatës nga Ministria dhe i cili duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 14.

Neni 18

18.1. Organi miratues mund të japë një miratim teknik të Kosovës për një produkt ndërtimi:

- i. për të cilin nuk ka as standard të Kosovës dhe as rregull teknik të Kosovës nga neni 6, ose
- ii. i cili ndryshon në mënyrë të dukshme nga një standard i Kosovës ose rregull teknike e Kosovës nga paragrafi paraprak.

18.2. Për dhënien, vazhdimin, rishikimin dhe anulimin e miratimit teknik të Kosovës do të zbatohen neni 15 dhe 16.

Neni 19

19.1. Miratim teknik i Kosovës mund të jepet edhe në mbështetje të miratimit teknik Evropian ose të një miratimi teknik të pranuar, i cili është dhënë një produkti ndërtimi nga një organ miratues që ka zyre të regjistruar jashtë kufirit. Miratim teknik i Kosovës i dhënë në këtë mënyrë, do të vërtetojë përshtatshmërinë e produktit për përdorimin e tij të paraparë me rregullat e Kosovës mbi kërkesat themelore për punimet e ndërtimit.

19.2. Miratimin teknik i Kosovës nga pika 1 e këtij neni, mund të jepet mbas inspektimit të dokumenteve mbi ekzaminimet, provat dhe vlerësimet complete të cilat kanë qenë bazë për dhënien e miratimit teknik Evropian ose miratimit teknik të pranuar. Në qoftë se është e nevojshme mund të bëhen inspekte, ekzaminime dhe prova shtesë për dhënien e miratimit teknik të Kosovës.

19.3. Ministria detalisht i përcakton procedurat e dhënies, vazhimit, rishikimit dhe anulimit të një miratimi teknik të Kosovës.

KAPITULLI V VLERËSIMI DHE VËRTETIMI I KONFORMITETIT ME KËRKESAT E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Neni 20

20.1. Prodhuesi është përgjegjës për vërtetimin e konformitetit të një produkti ndërtimi me kërkesat e specifikimeve teknike. Para vërtetimit të konformitetit përshtatshmëria e një produkti ndërtimi për përdorimin e tij të paraparë do të përcaktohet nga prova, kontrolli ose metoda të tjera të vlerësimit të konformitetit. Procedurat e vlerësimit dhe vërtetimit të konformitetit (në vijim: vlerësimi i konformitetit) të parapara me specifikimet teknike, do të kryhen nga vetë prodhuesi ose në bashkëpunim me organin e caktuar për vërtetimin e konformitetit.

20.2. Organi i caktuar për vërtetimin e konformitetit sipas pikës 1 të këtij neni, është organ certifikimi, organ inspektimi ose laborator testimi i cili mund të jetë një autoritet publik ose privat.

Neni 21

21.1. Për verifikimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit me specifikat teknike, shfrytëzohen këto metoda:

- i. Prova fillestare e mostrës së produktit nga prodhuesi ose organi i autorizuar,
- ii. sprovimi i mostrave të marra në fabrikë në përputhje me sprovat e parapara nga prodhuesi ose organi i autorizuar,
- iii. sprovimi i mostrave të marra në fabrikë, në tregun e hapur ose në një objekt ndërtimi nga prodhuesi ose organi i autorizuar,
- iv. sprovimi i mostrave nga një sasi që është përgatitur për shpërndarje, ose është shpërndarë, nga prodhuesi ose organi i autorizuar,
- v. Kontrolli i prodhimit në fabrikë,
- vi. Kontrolli fillestar i fabrikës dhe kontrolli fillestar i prodhimit në fabrikë nga organi i autorizuar,
- vii. Mbikëqyrja, gjykimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i kontrollit të prodhimit në fabrikë nga organi i autorizuar.

21.2. Kontrolli i prodhimit në fabrikë sipas paragrafit të mësipërm duhet të jetë një kontroll i përhershëm i brendshëm i prodhimit i bërë nga prodhuesi. Të gjitha elementet, kërkesat dhe masat e marra nga prodhuesi në lidhje me kontrollin e prodhimit në fabrikë, duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike në pajtim me politikat dhe procedurat e parapara.

21.3. Zgjedhja dhe kombinimi i metodave, për vërtetimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit, sipas pikës 1 të këtij neni, paraqet sistem të veçantë të vërtetimit të konformitetit që varet nga kërkesat teknike për produktin e veçantë të ndërtimit apo për grupe të produkteve të ndërtimit.

Neni 22

22.1. Vërtetimi i konformitetit të një produkti ndërtimi pre supozon që:

- i. prodhuesi i një produkti ndërtimi ka një sistem kontrolli të prodhimit në fabrikë me të cilin garanton se prodhimi është konform me specifikat teknike, ose
- ii. për një produkt ndërtimi të veçantë të përcaktuar në specifikimet teknike përkatëse, përveç sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë, për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e prodhimit apo të produktit, është i përfshirë edhe një organ i autorizuar certifikimi.

22.2. Zgjedhja e procedurave sipas pikës 1. do të varet nga:

- i. lloji i produktit të ndërtimit,
- ii. rëndësia e produktit në raport me kërkesat themelore për punimet e ndërtimit, në veçanti me ato që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë,

- iii. rezultatet e ndryshimeve në karakteristikat e produkteve të ndërtimit në lidhje me qëndrueshmërinë e tij,
- iv. ndjeshmërinë ndaj dëmtimeve gjatë prodhimit.

Neni 23

23.1. Procedurat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara me akte të veçanta, janë bazë për vërtetimin e konformitetit të produktit të ndërtimit, mbështetur në:

- i. deklaratën e konformitetit që e jep prodhuesi ose përfaqësuesi i tij , ose
- ii. certifikatën e konformitetit për sistemin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së prodhimit ose për produktin që e jep organi i certifikimit, sipas mënyrës së paraparë me pikën (ii) të paragrafit të parë të nenit 22.

23.2. Në qoftë se një organ certifikimi lëshon një certifikatë konformiteti për sistemin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së prodhimit, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, japin një deklaratë konformiteti për produktin e ndërtimit mbi bazë të kësaj certifikate.

23.3. Për prodhimet e ndara (ose jashtë serie), deklarata e konformitetit bazohet fillimisht në sprovimin e mostrës së produktit të ndërtimit. Në atë rast, kontrolli i produktit në fabrikë do të mjaftonte, vetëm në rast se nuk parashikohet ndryshe nga specifikimet teknike për produktet të cilat kanë një ndikim veçanërisht të rëndësishëm për shëndetin dhe sigurinë.

23.4. Ministria, me akt të veçantë, përcakton formën e dokumentit të konformitetit nga paragrafi i parë i këtij neni.

Neni 24

24.1. Pasi të jetë publikuar dokumenti i konformitetit , prodhuesi ose përfaqësuesi i tij shënon markën e konformitetit në produktin e ndërtimit, në përputhje me dispozitën e nenin 9 të këtij ligji.

24.2. Në një produkt ndërtimi që nuk është i përshtatshëm për përdorimin e paraparë , ose për të cilin marka e konformitetit nuk është miratuar, nuk mund të shënohet marka e konformitetit ose shenjë tjetër e ngjashme me të, e cila do të mund të krijonte konfuzion në treg ose te konsumatorët.

Neni 25

25.1. Një prodhues i produkteve të ndërtimit mund të angazhojë një organ tjetër certifikimi në procedurat e vlerësimit të konformitetit, vetëm nëse ai organi i certifikimit ka autorizim që vërteton aftësinë dhe përgjegjësinë e nevojshme për kryerjen e certifikimit të konformitetit sipas rregullave dhe procedurave të caktuara. Produktet të cilat janë në kompetencë të organit të certifikimit, duhet të shënohen në autorizim.

25.2. Një organ certifikimi mund t'i kryejë vetë detyrat e përshkruara në pikën 1. Ai mund t'ua besojë një ose më shumë nga këto detyra organeve të inspektimit ose laboratorëve të testimit, të cilat kanë autorizime përkatëse të dhëna nga organet

kompetente. Kryerja e këtyre detyrave të mund t' u besohen edhe organeve që kanë autorizim sipas nenit 26, duke pasur parasysh përshkrimin e aktiviteteve të organeve të veçanta të vlerësimit të konformitetit nga pika 15,16 dhe 17 të nenit 4. të këtij ligji.

Neni 26

Për organet e autorizuar për vërtetimin e konformitetit, që e kanë zyrën e regjistrimit në Kosovë, Ministria me akte nënligjore përcakton detyrat sipas nenit 25, në përputhje me rregullat e përgjithshme të vlerësimit të konformitetit të produktit, që i plotësojnë këto kërkesa:

- i. numrin e nevojshëm të personelit, të mjeteve dhe pajisjeve,
- ii. personelin që ka përgatitje profesionale dhe përgjegjësi në punë,
- iii. paanshmërinë në kryerjen e provave, përgatitjen e raporteve, nxjerrjen e certifikatave dhe kryerjen e mbikëqyrjes, të stafit dhe personelit teknik në lidhje me të gjitha qarqet, grupet ose personat e interesuar drejtpërdrejt ose indirekt për produktet e ndërtimit,
- iv. ruajtjen e sekretit profesional nga personeli,
- v. nënshkrimin e siguracionit.

KAPITULLI VI MBIKËQYRJA E TREGUT

Neni 27

27.1. Përmbushja e kërkesave të parapara me këtë ligj dhe aktet e nxjerra në bazë të tij përkitazi me produktet e ndërtimit që nxirren në treg, do të inspektohen nga Inspekcioni i tregut (ose organi i autorizuar).

27.2. Sipas këtij ligji inspektorët e tregut (ose organi i autorizuar), përveç autorizimit për zbatimin e masave që dalin prej akteve e që kanë të bëjnë me punën e tyre, kanë edhe këto kompetenca :

- i. të kërkojnë nga furnizuesi që t'ia paraqesë inspekcioni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe t' ia ofrojë për inspektimi të gjitha dokumentet për konformitetin dhe dokumentet teknike të produkteve të ndërtimit,
- ii. të kryejë ekzaminime të përshtatshme dhe prova të produkteve të ndërtimit, në përputhje me konformitetin sipas specifikimeve teknike,
- iii. të marrin mostra të produkteve të ndërtimit dhe të bëjnë vlerësimin e konformitetit të tij,
- iv. të urdhërojnë marrjen e dokumenteve të konformitetit për produktet e pajohura të ndërtimit,
- v. të urdhërojnë eliminimin e mangësive të konformitetit,

- vi. të kërkojë që marka e përshkruar e konformitetit t'u vihet produkteve të ndërtimit ose marka e ndaluar e konformitetit të hiqet,
- vii. të ndalojë nxjerrjen në treg të produkteve të ndërtimit në rast të moskonformitetit të tyre, të kufizojë tregtimin e produkteve ose të urdhërojë heqjen e tyre nga tregu dhe të aplikojë masa shtesë për të siguruar se urdhëresa po respektohet,
- viii. të ndalojë përkohësisht, për kohën që nevojitet për kryerjen e ekzaminimeve ose provave, çdo furnizim, ofertë ose ekspozitë të produkteve të ndërtimit, për sa kohë që ekziston dyshimi i bazuar se këto produkte nuk janë konform rregullave,
- ix. të urdhërojë shkatërrimin e produkteve të ndërtimit në rast moskonformiteti kur kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve.

27.3. Inspekcioni i tregut (ose organi i autorizuar) mundet që në suaza të mbikëqyrjes së tregut të përcaktojë një institucion të kualifikuar për të kryer ekzaminimet dhe provat e nevojshme sipas paragrafëve të mësipërme.

Neni 28

28.1. Shpenzimet e procedurave të inspektimit (shpenzimet për analiza, shpenzimet ditore, shpenzimet për udhëtime dhe shpenzimet tjera të bëra në lidhje me procedurat e paraqitura) të cilat përfundojnë në disfavor për personin përgjegjës do ti bartë vetë ai person.

28.2. Ankesa kundër vendimit për mbikëqyrjen e tregut, i marrë në mbështetje të zbatimit të autorizimeve sipas paragrafit të dytë të nenit 27., nuk e ndalon zbatimin e tij.

Neni 29

Qeveria e Kosovës mund të parashohë përmbajtjen dhe mënyrën e informimit të shteteve tjera apo të subjekteve ndërkombëtare për masat e aplikuara nga organet vendëse të cilat vlejné në tregun ndërkombëtar, duke kufizuar nxjerrjen në treg të produkteve të ndërtimit ose duke urdhëruar tërheqjen e tyre nga tregu me qëllim të mbrojtjes së interesave publike.

KAPITULLI VII PROCEDURAT E VEÇANTA

Neni 30

30.1. Në mungesë të specifikimeve teknike sipas nenit 5 për çdo produkt ndërtimi, Kosova si shtet importues, varësisht nga kërkesat e veçanta, vlerëson se produkti është në konformitet me dispozitat në fuqi të Kosovës, në rast se ai ka kaluar me sukses provat dhe kontrollet e kryera nga organi kompetent i shtetit prodhues, sipas metodave në fuqi në Kosovë ose të pranuar si të barasvlershme nga Kosova, sipas marrëveshjeve reciprokisht të nënshkruara.

30.2. Për t'u siguruar mbi vërtetësinë e konformitetit të produktit të ndërtimit, Kosova mund t'i kërkojë informacione shtesë organit kompetent të shtetit prodhues për këtë

qëllim. Nëse Kosova ka mosmarrëveshje me atë organ ajo do të argumentojë pozicionin e saj mospajtues dhe da ta informojë shtetin prodhues.

30.3. Kosova do t'i marrë të gjitha raportet dhe dokumentet e konformitetit të lëshuara në një shtet prodhues në përputhje me këtë nen, ekuivalente me raportet dhe dokumentet e konformitetit të lëshuara nga organet kompetente për vërtetimin e konformitetit që e ka zyrën e regjistruar në Kosovë.

KAPITULLI VIII SANKSIONET

Neni 31

31.1. Në mbështetje të këtij ligji, për shkeljet që nuk paraqesin vepër penale, por kundërvajtje administrative, personi juridik do të dënohet:

1. Me të holla, në shumën prej 2.000 deri 5.000 €, kur:

- i. nxjerr në treg produktin e ndërtimit në kundërshtim me nenet 5, 6 ose 7;
- ii. bën një deklaratë të harmonizimit të produktit të ndërtimit në kundërshtim me nenin 8;
- iii. jep një miratim teknik Evropian në kundërshtim me nenet 11 dhe 16;
- iv. jep një miratim teknik Kosovar në kundërshtim me nenet 17, 18, 19;
- v. nuk e vë markën e konformitetit në produktin e ndërtimit në përputhje me paragrafin e parë të nenit 24;
- vi. në kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit 24 në produktin e ndërtimit vë një markë konformiteti ose çdo markë tjetër ekzistuese e cila mund të krijojë konfuzion në treg ose mashtron konsumatorët;
- vii. pranon organin e certifikimit për vërtetimin e konformitetit në kundërshtim me nenin 25;
- viii. kryen detyrat e organit kompetent në vërtetimin e konformitetit duke marrë vendime në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 26;
- ix. në kundërshtim me nenin 27, nuk vepron në përputhje me vendimet e inspekcionit të tregut.

31.2. Me para në shumën prej 500 deri 2.000 € dënohet personi përgjegjës fizik dhe juridik për kundërvajtje nga nenet e mësipërme.

KAPITULLI IX ANKESAT

Neni 32

32.1. Ankesa kundër shqiptimit të gjobave i paraqitet inspekcionit të tregut (ose organit kompetent) brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Inspekcioni i tregut do të vendos për ankesë brenda afatit kohor prej 30 ditësh.

32.2. Ankesa kundër vendimit të inspektionit të tregut, ose kur nuk vendoset përkitazi me ankesën brenda afatit kohor të mësipërm, mund ti paraqitet gjykatës kompetente.

KAPITULLI X DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 33

33.1. Derisa të nxirren specifikat teknike që parashihen me këtë ligj ose me rregullat e veçanta nga paragrafi i parë i nenit 2 do të aplikohen standardet mbi produktet e ndërtimit dhe specifikacionet tjera të nxjerra dhe që aplikohen në nivel ndërkombëtar, veçanërisht në shtetet e BE-së.

33.2. Qeveria në bazë të këtij ligji, do të nxjerrë akte nënligjore dhe rregulla teknike.

Neni 34

34.1. Ministria do t' i përcaktojë çështjet e produkteve të ndërtimit (MTI) do të nxjerrë aktet nënligjore sipas neneve 23, 25 dhe 33 të këtij ligji.

34.2. Ministria do të botojë përkthimin e interpretimit të dokumenteve të parapara me nenin 3, brenda afatit prej 24 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 35

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr. 02/L-14
23 mars 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci